



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/67

Datë: 26.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen procesverbalet nga mbledhjet korresponduese\elektronike: 64 dhe 65 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/67

Datë: 26.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 31. paragrafi 9 i Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës ua vazhdon mandatin Kryesuesit dhe anëtarit të Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike në këtë përbërje:
  - 1.1. Mirsim Beqiri, Kryesues i KHAIA-s, dhe Hetues i Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike; dhe
  - 1.2. Arben Dika, anëtar i KHAIA-s, dhe Hetues i Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike.
2. Mandati i të emëruarëve nga pika 1.1 dhe 1.2 e këtij vendimi zgjat pesë (5) vjet.
3. Kryesuesi dhe anëtari i Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike sipas pikës 1. të këtij vendimi detyrat dhe përgjegjësit do t'i ushtrojnë në pajtim me Ligjin për Aviacionin Civil Nr.03/L-051 dhe legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/67  
Datë: 26.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, Ligjit Nr.07/L-016 për Rimëkëmbje Ekonomike – COVID 19, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, në pajtim me Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2021-2023 i aprovuar me Vendimin nr. 01/02 datë 05.06.2020, si dhe bazuar në Vendimin nr. 06/58 datë 14.01.2021 mbi Arovimin e Masave për zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike për vitin 2021, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Plani për Implementimin e Programit për Rimëkëmbje Ekonomike - Masa 15 "Mbështetje për programet ekzistuese dhe të reja që lidhen me zhvillimin rajonal përmes Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, që ndikojnë në zhvillimin rajonal të balancuar".
2. Ndahen mjetet buxhetore për Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, sipas Masës 15 të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 06/58 të dt. 14.01.2021 për Arovimin e Planit për Zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike në vlerë prej 1,000,000.00 € (një milion euro), për mbështetjen e programeve ekzistuese dhe të reja, që lidhen me zhvillim rajonal të balancuar dhe ndikojnë në zhvillimin rajonal të balancuar.
3. Obligohet Ministria e Financave për alokimin e mjeteve tek Ministria e Zhvillimit Rajonal, në kategorine ekonomike Subvencione dhe Transfere (Kodi: 10/221/11321/200/00098/0131), kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere nga Pako e Rimëkëmbjes Ekonomike - Masa 15, viti 2021, sipas pikës 2 të këtij vendimi.
4. Obligohet Ministria e Zhvillimit Rajonal që konform planit, udhëzimit dhe kritereve sektoriale, të zhvillojë procedurat e mëtejme për implementimin dhe zbatimin e masave të përcaktuara në Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**



\_\_\_\_\_  
Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/67

Datë: 26.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 pika 6 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej: 185,073.15€, në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZHR) me kod 221, nën programi Administrata Qendrore me kod 11321, nga kategoria e shpenzimeve kapitale konkretisht nga projekti: "Programi për zhvillim rajonal", me kod 18782 në 2 ( dy) projekte kapitale në përputhje me 2 (dy) aneks-marrëveshjet e mirëkuptimit për projekte kapitale të nënshkruara nga Ministri i MZHR-së dhe Kryetarët e Komunave.
2. Mjete nga pika 1 e këtij vendimi rialokohen nga projekti: "Programi për zhvillim rajonal "me kod 18782 në këto projekte, me shumatat e cekura si në vijim;
  - 2.1. Projekti i zhvillimit socio ekonomik në komunën e Kamenicës - kanalizim në shumë prej 30,000.00 €;
  - 2.2. Projekti i zhvillimit të turizmit në bjeshkët e Deçanit në shumë prej 155,073.15 €
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/67  
Datë: 26.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Strategjia për Zhvillim Rajonal 2020-2030 dhe Plani i veprimit
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/67

Datë: 26.02.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15, paragrafi 6 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej: 215,025.45€, në Ministrinë e Pushtetit Lokal (MAPL) me kod 212, nën programi Administrata Qendrore me kod 11312, nga kategoria e shpenzimeve kapitale konkretisht nga projekti: "Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndër-komunal" me kod 15633 në 6 (gjashtë) projekte kapitale në përputhje me 6 (gjashtë) aneks-marrëveshjet e mirëkuptimit për projekte kapitale të nënshkuara nga Ministri i MPL-së dhe Kryetarët e Komunave.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi rialokohen nga projekti: "Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndër-komunal" me kod 15633 në këto projekte të reja, konform shumave të cekura si në vijim:
  - 2.1. Ndërtimi i parterit të lodrave në çerdhen e fëmijëve- Komuna e Mitrovicë së Veriut, në vlerën prej 21,529.10€;
  - 2.2. Asfaltimi i rrugës në "Llukac të Begu"- Komuna e Istogut, në vlerë prej 50,000€;
  - 2.3. Asfaltimi i rrugëve të pa kategorizuara në Komunën e Zveqanit, në vlerë prej 49,847.75€;
  - 2.4. Ndërtimi i një pjese të trotuarit me sipërfaqe gjelbëruese në rrugën e Mbretit Peter I, në vlerën prej 23,885.60€;
  - 2.5. Ndërtimi i ndriçimit të rrugëve në B.L. të Leposaviqit- Komuna e Leposaviqit në vlerën prej 19,825.10€;
  - 2.6. Ndërtimi i ndriçimit në oborrin e SHM "M.P. Alas", Komuna e Mitrovicës Veriore, në vlerë prej 49,937.90€.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Pushtetit Lokal për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**



\_\_\_\_\_  
Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/67

Datë: 26.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Z. Lulzim Syla, Kryeinspektor i Inspektoratit të Tregut, i vazhdohet mandati edhe për katër (4) vjet.
2. Z. Syla i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e percaktuara me legjislacionin në fuqi.
3. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/67

Datë: 26.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në Marrëveshjen financiare për IPA 2019, pjesa e dytë, objektivi 2, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Obligohen të gjitha institucionet qeveritare të cilat disponojnë të dhëna mbi çmimet e shitjeve në të gjitha transaksionet e pronave të paluajtshme, të fillojnë të bëjnë publikimin në ueb faqet e tyre.
2. Obligohet organi propozues i Projektligjit për Kadastrin që të sigurojë përfshirjen e dispozitave ligjore që mundësojnë transparencën për çmimet e shitjeve në transaksionet e pronave të paluajtshme.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Arsyetim**

Qeveria e Republikës së Kosovës, me qëllim të përmbushjes së obligimeve të marra në kuadër të treguesit 3. të programit të përkrahjes buxhetore të IPA 2019, pjesa 2, Objektivi 2, e cila ka të bëjë me transparencën në tregun e pasurive të paluajtshme për të rritur të ardhurat dhe luftimin e informalitetit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë